

LIGJ
Nr.9319, datë 25.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MALIT TË ZI PËR VENDOSJEN E LINJËS NDËRKOMBËTARE LIQENORE PËR UDHËTARË SHKODËR-VIRPAZAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Malit të Zi për vendosjen e linjës ndërkombëtare liqenore për udhëtarë Shkodër-Virpazar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4421, datë 14.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA

MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MALIT TË ZI PËR VENDOSJEN E LINJËS NDËRKOMBËTARE LIQENORE PËR UDHËTARË SHKODËR-VIRPAZAR

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Malit të Zi, më poshtë thirrur “Palët”,

duke dëshiruar nxitjen e bashkëpunimit miqësor në fushën e transportit dhe në veçanti të transportit të udhëtarëve në liqenin e Shkodrës,
kanë rënë dakord:

Neni 1

Të dyja Palët bien dakord të fillojnë dhe të operojnë linjën ndërkombëtare sezonale për turistët ndërmjet Shkodrës dhe Virpazar, me kalime kufitare në Shkodër (Ura e Bunës) dhe Virpazar.

Të dyja Palët bien dakord që linja të fillojë të funksionojë mbi bazat e reciprocitetit, në përputhje me legjislacionin kombëtar respektive të tyre.

Neni 2

Palët kanë rënë dakord që linja të operohet nga subjekte të regjistruara, në përputhje me legjislacionin kombëtar respektiv të tyre.

Neni 3

Palët kanë rënë dakord, që qytetarët e secilës palë, mbajtës të pasaportave të vlefshme, do të hyjnë dhe do të lënë territoret e vendit tjetër në kalimet kufitare të përcaktuara me viza në përputhje me regjimin e vizave të vendosura ndërmjet të dy vendeve.

Qytetarët e njërës Palë, gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër ose dëshirojnë të qëndrojnë në territorin e Palës tjetër për një periudhë më të gjatë se sa është parashikuar në regjimin e vizave të vendosur, janë të detyruar të kërkojnë nga autoritetet respektive, lëshim vize ose lejë qëndrimi.

Qytetarët e njërës Palë, gjatë qëndrimit në territorin e Palës tjetër janë të detyruar të zbatojnë ligjet dhe rregullat në fuqi të kësaj Palë.

Çdo palë rezervon të drejtën të refuzojë hyrjen në territorin e saj ose të anulojë qëndrimin në territorin e saj të qytetarëve të Palës tjetër të cilët ajo i konsideron “*non grata*”.

Neni 4

Gjatë periudhës së lundrimit nga kalimi kufitar deri në kufirin shtetëror të secilës Palë:

Anijet nuk duhet të kenë kontakt me anije të tjera, përveç atyre të policisë, doganave dhe anijeve të autoritetit portual.

Ndalohej çdo ngarkim ose shkarkim i udhëtarëve ose mallrave nga dhe për në anije.

Neni 5

Kapiteni i anijes është i detyruar t’u paraqesë autoriteteve respektive dokumentet e kërkuara bazuar si mbi legjislacionin kombëtar, ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Neni 6

Udhëtarëve nuk u lejohej të transportojnë mallra për përdorim tregtar, dhe janë të detyruar t’u deklarojnë autoriteteve të doganës bagazhin e tyre personal dhe mallrat që nuk janë për përdorim tregtar.

Neni 7

Autoritetet kompetente do të krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme për shkëmbim miqësor informacionesh.

Neni 8

Orari i udhëtimit të anijes që operon në linjë do të miratohet nga të dyja Palët në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Autoritetet respektive kompetente të secilës Palë duhet të informojnë njëra-tjetrën me shkrim rreth “Orarit të udhëtimit” të miratuar.

Neni 9

Operatorët e të dy vendeve do të respektojnë ligjet dhe rregullat në fuqi përsa i përket regjimit të taksave. Regjimi konkret i pagesës së taksave do të përcaktohet me marrëveshje ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja Palëve.

Neni 10

Anijet që operojnë në linjë janë të detyruara të kenë në bord të gjithë dokumentacionin dhe pajisjet e nevojshme në përputhje me legjislacionin kombëtar respektivë të tyre.

Neni 11

Kjo Marrëveshje mund të amendohet me konsensusin e përbashkët të të dyja Palëve.

Neni 12

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë pas datës kur të dyja Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që procedurat respektive për hyrjen e saj në fuqi sipas legjislacionit kombëtar të secilës Palë janë përmbushur.

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi. Ajo do të vazhdojë të qëndrojë në fuqi për një periudhë tjetër 5-vjeçare për sa kohë nuk denoncohet nga njëra nga palët kontraktuese me shkrim, 6 muaj përpara skadimit të çdo periudhe vlefshmërie, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Kjo Marrëveshje do të jetë e zbatueshme nga data e firmosjes.

Firmosur në Podgoricë më 2.7.2004 në dy kopje origjinale autentike në gjuhën angleze.